

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR
“KALINJOTI”
DATEË 22.06.2021


Sot, në datën 22.06.2021, u vendos themelimi i një shoqërie bashkëpunimi bujqësor e emërtuar Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Kalinjoti”. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin.

Kjo shoqëri u krijua me vullnetin e plotë dhe të lirë të anëtarëve të saj:

1. **Vesaf Musa**, i datëlindjes 02-03-1958, lindur në Cerkovinë, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **F80302164U**;
2. **Aristotel Kaçani**, i datëlindjes 02-03-1974, lindur në Skrofotinë, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal **H40302047W**;
3. **Lavdurim Musa**, i datëlindjes 14-05-1963, lindur në Cerkovinë, identifikuar me pasaportë me nr. personal **G30514117C**;
4. **Eduart Beqiraj**, i datëlindjes 26-08-1972, lindur në Cerkovinë identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **H20826028L**;
5. **Mendim Baçaj**, i datëlindjes 09-03-1952, lindur në Llakatund, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **F20309054N**;
6. **Hair Xhafaj**, i datëlindjes 14-01-1967, lindur në Vlorë, Vlorë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **G70114059J**;
7. **Bruno Musa**, i datëlindjes 20-06-1992, lindur në Vlorë, identifikuar me pasaportë me nr. personal **J20620069N**.

NENI 1– EMËRTIMI

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë do të jetë **Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Kalinjoti”**.



NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Kalinjoti” themelohet në formën e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, kryesisht Ligjit nr.38/2012 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe dispozitave përkatëse në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 3 – SELIA


- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **“Fshati Skrofotinë, Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, K.P. 9411, Shqipëri”**
- 3.2 Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në Njësinë Administrative Novoselë dhe kudo tjetër ku ndodhet anëtarësia e saj.

NENI 4 – OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së ShBB konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
 - A. *Kultivimi, prodhimi dhe tregtimi i vajit të ullirit cilësor kalinjot.*
 - B. *Bashkëpunimit si grup fermerësh me shoqatat e shoqërisë civile dhe projektet mbështetëse të skemave kombëtare. Shërbimi në ullinj të kaninjotë dhe përmirësimin e tyre me krijimin e kushteve optimale për prodhim.*
 - C. *Rritje e prodhimit të produkteve të tjera në kushte sa më cilësore dhe kapjen e tregut me etiketën e zonës autoktone.*
 - D. *Zhvillimi i agroturizmit me produktet bio të prodhuara në këtë zonë.*
 - E. *Rritja e nivelit ekonomik të fermerëve që punojnë me ullirin kalinjot.*

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



2

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË DHE KONTRIBUTET

6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100,000 ALL (njëqind mijë lekë), i ndarë në 7 pjesë të zotëruara nga anëtarët themelues në masën:

| | | | |
|------------------|---------|-------------|---------------|
| Vesaf Musa | 14.29% | 14,290 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Aristotel Kaçani | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Lavdurim Musa | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Eduart Beqiraj | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Mendim Baçaj | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Hair Xhafaj | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |
| Bruno Musa | 14.285% | 14,285 lekë | 1 pjesë/kuotë |

6.2 Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert.

6.3 Anëtarët janë zotërues të pjesëve sipas vlerës së kontributit të tyre në kapital.

NENI 7 –TRANSFERIMI DHE NDRYSHIMI I KAPITALIT

7.1 Pjesët e kapitalit mund të fitohen/transferohen sipas parashikimeve të ligjit 38/2012 dhe dispozitave të Statutit të SHBB.

7.2 Ndryshimi i kapitalit nuk mund të jetë në asnjë rast më i vogël se kapitali minimal.


NENI 8 – ORGANET E SHBB

Organet e Shoqërive të Bahkëpunimit bujqësor janë Asambleja e Përgjithshme dhe Adminsitratori.

8.1 Asambleja e Përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqërisë. Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të saj parashikohen në Statutin e ShBB-së.

8.2 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje.

8.3 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të




drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr.38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor” dhe në çdo rast në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit Shoqërisë.

8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

“Z. Vesaf Musa, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02-03-1958, lindur në Cerkovinë, Vlorë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal F80302164U.

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Nënshkrimi



8.5 Administratori i Shoqërisë përfaqëson ShBB-në pranë QKB për të bërë regjistrimin e saj.

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 8 (tetë) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.


10.2 Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të ShBB-së pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Kalinjoti”


PËRFAQËSIA THEMELUESE:

VESAF MUSA


ARISTOTEL KAÇANI




LAVDURIM MUSA




EDUART BEQIRAJ



MENDIM BAÇAJ



HAIR XHAFAJ



BRUNO MUSA

